



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR.4

Datë 17.03.2026 ora 13 : 00^{oo}


Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Për shkak të një keqfunksionimi për arsye të panjohura kjo mbledhje u regjistrua pa zë dhe zbardhja është bërë në mënyrë të përmbledhur.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak me Nr.1069.Prot datë 12.03.2026, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 03.02.2026
- 3- Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 25.02.2026.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Blllok - Ndihmës 6%”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2026 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të veprimit për barazinë gjinore të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026-2028”.
- 8- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029.
- 9- Njohje me planin operacional vjetor 2026-2027, “Për administrimin e pyjeve dhe të kullotave të Bashkisë Rrogozhinë”.
- 10-Raport nga drejtoria e bujqësisë , mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe për gjendjen e rezervuareve në territorin e bashkisë Rrogozhinë.
- 11-Raport, mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” për vitin 2025 si dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2026.
- 12- Informimi i Këshillit Bashkiak mbi “ Parandalimin e Dhunës me bazë gjinore”.



13-Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Indrit Dedej, Silvana Aliu, Erind Tosku, Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Lorena Baku, Altin Tosku.

Mungojnë :

Mitat Daja, Sokol Gosa, Dhurata Meka, Saimir Cani, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Lije Dedej Hekuran Xhani, Mukades Gixhari.

Të ftuar :

1. Andi Proshka - Nënkyetar i Bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
4. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
6. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
10. Adriatik Lekaj - Përgjegjësi i zyrës së emergjencave civile.
11. Artur Kaja - Përgjegjës i sektorit të pyjeve.
12. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Erind Tosku – Zëvendëskryetar i Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 12- Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

-2-



Përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

-Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : Indrit Dedej, Silvana Aliu, Erind Tosku, Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Lorena Baku, Altin Tosku.

-Lexojmë Vendimin me karakter individual që u mor në mbledhjen e këshillit të datës 25.02.2026 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar , si më poshtë :

Vendim nr . 13 . Për pranimin e të moshuarës znj. Drita Shira në Qendrën e Përkujdesit rezidencial për të moshuar "Missionaries of Charity" (Motrat e nënë Terezës) Tiranë.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.


Shpati Kolgega . Për sa i përket rendit të ditës në mbledhjen paraardhëse morëm një vendim ku ramë dakord të gjithë si këshill që fondi i emergjencave të përdorej për t'i ardhur në ndihmë banorëve të fshatit Domen duke rehabilituar dhe bërë të mundur rrugën lidhëse me këtë fshat. Duhej që në këtë mbledhje të na vinte projektvendimi përkatës i cili nuk na ka ardhur. Gjithashtu para 2-3 mbledhjesh Kryetari i Komisionit të përkohshëm të këshillit bashkiak për verifikimin e procesit të rindërtimit për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 me nivel dëmi DS4, DS5 në Bashkinë Rrogozhinë, i ka paraqitur disa kërkesa administratës në lidhje me çështjen që ka objekt verifikimi ky komision përgjigje e cila akoma nuk na ka ardhur. Gjendur në këto kushte i propozoj pozitës dhe opozitës që ne të miratojmë ndihmat ekonomike deri tek pika 6, dhe pika e tjera për mungesë serioziteti nga ana e administratës të mos i marrim në shqyrtim.

Silvana Aliu . Edhe unë jam dakord me mendimin e Shpatit.

Fatmira Thartori . Ta fusim dhe pikën 7 për shqyrtim.

-Këshilltarët bien dakord që rendi i ditës të shqyrtohet deri në pikën 7 dhe të tjerat mos merren në shqyrtim në shenjë proteste pasi në mbledhjen paraardhëse u kërkuar të vihej në dispozicion një projektvendim për rehabilitimin e rrugës që lidh fshatin Domen në Njësinë Administrative Kryevidh i cili nuk ka ardhur nga ana e administratës si dhe që nuk kanë marrë informacion për kërkesat e bëra nga komisioni i përkohshëm i këshillit bashkiak për verifikimin e procesit të rindërtimit për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 me nivel dëmi DS4, DS5 në Bashkinë Rrogozhinë.

-3-



Erind Tosku . Kalojmë në pikën e parë, miratim i rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.*

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 03.02.2026. E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.*

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 25.02.2026. E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.*

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës. Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

-Pas relatimit të drejtorit.përkatës.

Erind Tosku . E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-*Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 4 (katër) e rendit të ditës.*

Vendim nr.14. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga nënkryetari ushtrues i detyrës së kryetarit të bashkisë me Nr.705.Prot datë 16.02.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.705/1.Prot datë 16.02.2026.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

-Pas relatimit të drejtorit përkatës.



Erind Tosku . E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.15. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga nënkryetari ushtrues i detyrës së kryetarit të bashkisë me Nr.706.Prot datë 16.02.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.706/1.Prot datë 16.02.2026.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 6, të rendit të ditës Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2026 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

-Pas relatimit të drejtorit përkatës.

Erind Tosku . E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.


Vendim nr.16. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga nënkryetari ushtrues i detyrës së kryetarit të bashkisë me shkresë Nr.1024.Prot datë 10.03.2026, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2026 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1024/1.Prot datë 10.03.2026.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 7, të rendit të ditës, miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të veprimit për barazinë gjinore të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026-2028”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

-Pas relatimit të drejtorit përkatës.

Erind Tosku . E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 7 (shtatë) e rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Vendim nr.17. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga nënkryetari ushtrues i detyrës së kryetarit të bashkisë me shkresë Nr.708.Prot datë 16.02.2026, “Për miratimin e planit vendor të veprimtimit për barazinë gjinore të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026-2028”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.708/1.Prot datë 16.02.2026.

-Këshilltarët ngrihen për t’u larguar nga mbledhja.

Erind Tosku . Mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 21 min ; 13 sek.
- Ky procesverbal i përmbledhur mbyllet në faqen 6 (gjashtë).

Zbardhi procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT
ERIND TOSKU